

AGJENCIONI PËR FINANCIM NË KOSOVË

Pasqyrat financiare për vitin e
përfunduar më 31 dhjetor 2025
të përgatitura sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
(SNRF)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1 - 2
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7 – 35

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Agjencioni për Financim në Kosovë

Mendimi

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencioni për Financim në Kosovë (më poshtë "Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2025, dhe pasqyrën e të ardhurave të gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, dhe pasqyrën e rrjedhës së parave për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë informacionin për politikat materiale të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2025, dhe të performancës financiare dhe rrjedhën e parave të saj për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për mendimin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë përshkruar më tej në Seksionin e Përgjegjësisë të Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Bordit Ndërkombëtar të Standardeve për Kontabilistët Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarsisë) (Kodi IESBA), së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike të tjera në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për mendimin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhimi i gjykon të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që jenë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç nëse menaxhimi synon të likuidojë Organizatën ose për të ndaluar operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve, dhe për të lëshuar një raport auditimi që përfshin mendimin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulon një gabim material kur ai ekziston. Gabimet mund të dalin nga mashtrimi ose gabimi dhe janë të konsideruara materiale nëse, individualisht ose së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për mendimin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Marrim njohuri të kontrollit të brendshëm që janë relevante për auditimin në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një mendimi për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të sjellin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne vlerësojmë se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shënimet e lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse këto shënimet janë të pamjaftueshme, për të modifikuar mendimin tonë. Konkluzionet tona bazohen në dëshmitë e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Organizata të ndalojë për të vazhduar si një subjekt i qëndrueshëm.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, në lidhje me, qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.


Arzie Begolli
Auditorë Ligjore
31 mars 2026



Nexia Kosovo Audit LLC

Nexia Kosova Audit L.L.C

Str. Xhevdet Doda, Dukagjini Center,
Kati 3, No.17, Prishtinë, Kosova

D: +383 49 882 587 | T: +383 49 974 293


E: audit@nexia-ks.com | info@nexia-ks.com


W: nexia-ks.com | W: nexia.com

Agjencioni për Financim në Kosovë
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2025

		Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
	Shënimet	(në EUR)	(në EUR)
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	2,226,657	5,398,197
Depozita me afat	8a	1,750,000	1,000,000
Huatë për klientët	9	93,146,083	75,008,245
Prona, impiantet dhe pajisjet	10	476,256	461,637
Pasuritë e paprekshme	11	347,203	259,760
E drejta e përdorimit të aseteve	12	929,269	699,842
Pasuritë tjera	13	198,646	123,907
Gjithsej pasuritë		99,074,114	82,951,588
Detyrimet			
Huamarrjet	14	79,446,884	66,368,516
Detyrimet për qira	12	967,150	743,424
Detyrimet e tjera	15	323,173	226,472
Provizionet	16	219,313	178,513
Gjithsej detyrimet		80,956,520	67,516,925
Balanca e fondit			
Fondet e dhuruara	17	2,093,605	2,093,605
Suficiti i akumuluar		16,023,989	13,341,058
Gjithsej fondi		18,117,594	15,434,663
Gjithsej detyrimet dhe balanca e fondit		99,074,114	82,951,588

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për lëshim nga menaxhmenti i Agjencionit për Financim në Kosovë më 27 mars 2026.


MSc. Xhevdet Spahija
Drejtor Ekzekutiv


MSc. Zaimire Deçani Beqiri
Udhëheqese e Departamentit të
Financave

Shënimet shoqëruese nga faqe 8 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

		Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
	Shënimet	(në EUR)	(në EUR)
Të ardhura nga interesi	18	15,024,548	12,574,069
Shpenzimet e interesit	14	(5,241,554)	(3,986,680)
Të ardhura neto nga interesi		9,782,994	8,587,389
 Të ardhura të tjera	19	113,545	157,980
 Fitimi/(Humbje) nga zhvlerësimi i huave për klientë	9	(200,161)	(486,077)
Shpenzimet e personelit	20	(4,631,632)	(4,296,104)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10-11	(273,859)	(273,309)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	21	(1,674,085)	(1,475,219)
Amortizimi i të drejtës së përdorimit të qirave	12	(433,871)	(397,381)
Suficiti për vitin		2,682,931	1,817,279
 Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
 Gjithsej suficiti gjithëpërfshirëse për vitin		2,682,931	1,817,279

Shënimet shoqëruese nga faqe 7 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Fondet e dhuruara (në EUR)	Teprica e mbajtur (në EUR)	Gjithsej gjendja e fondit (në EUR)
Gjendja më 1 janar, 2024	2,093,605	11,523,779	13,617,384
Teprica e vitit	-	1,817,279	1,817,279
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,093,605	13,341,058	15,434,663
Teprica e vitit	-	2,682,931	2,682,931
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	2,093,605	16,023,989	18,117,594

Shënimet shoqëruese nga faqe 7 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Pasqyra e rrjedhjes së parasë
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

		Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
	Shënimet	(në EUR)	(në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Suficiti i vitit		2,682,931	1,817,279
Rregullimet:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10-11	273,859	273,309
Amortizimi i drejtes se perdorimit te qirave	12	433,871	397,381
Humbje nga zhvlerësimi i huave financiare	9	200,161	486,077
Provizionet	16	219,313	178,513
Të ardhurat nga interesi	18	(15,024,548)	(12,574,069)
Shpenzimet e interesit	14	4,636,660	3,530,128
Shpenzimet e interesit-IFRS 16		63,041	34,416
		(6,514,712)	(5,856,966)
Ndryshimet në :			
Kreditë për konsumatorët		(18,263,961)	(13,943,901)
Pasuritë tjera		(284,059)	(36,007)
Detyrime tjera		137,499	125,807
Ndryshimet ne kapitalin punues:			
Interesi i arkëtuar		14,870,439	12,652,816
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		(10,054,794)	(7,058,251)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurisë së prekshme	10	(195,879)	(64,961)
Blerjet e pasurisë së paprekshme	12	(180,042)	(134,085)
Ndryshimi ne depozita		(750,000)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(1,125,921)	(199,047)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Disbursimet gjatë vitit	14	38,983,500	33,300,000
Pagesat e bëra gjatë vitit	14	(26,055,986)	(19,956,449)
Shlyerja e detyrimeve të qirasë		(498,473)	(436,741)
Interesi i paguar	14	(4,419,866)	(3,651,241)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		8,009,175	9,255,563
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të parasë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	8	5,398,197	3,399,932
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit	8	2,226,657	5,398,197

Shënimet shoqëruese nga faqe 7 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

1. TË PËRGJITHSHME

Agjencioni për Financim në Kosovë ("Organizata" ose "AFK") u themelua në Tetor të vitit 2000 në Kosovë, si një institucion mikrofinanciar dhe u financua nga kontributet e marra nga Mercy Corps ("MC"), një organizatë joqeveritare me bazë në SHBA. Misioni i saj është të ofrojë asistencë dhe përkrahje për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë përmes dhënies së kredive dhe ofrimit të këshillave për çështje biznesore.

Rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të Organizatës dhe Mercy Corps-it u përcaktuan sipas një Memorandumi Mirëkuptimi (MM) që fillimisht ka hyrë në fuqi nga data 21 shkurt 2002 deri më 30 qershor 2008, duke u zgjatur për të vazhduar më tutje nga data 30 qershori 2008 edhe për periudha të tjera prej pesë vjetësh, të rinovueshme me pëlqimin e të dy palëve.

Bazuar në një marrëveshje granti të nënshkruar nga Organizata dhe Mercy Corps në dhjetor 2016, shuma e huasë prej 2,235,788 Euro i është dhuruar AFK-së (shih Shënimin 16). Granti i nënshtrohet termave dhe kushteve sipas paragrafit 5 të marrëveshjes së grantit, i cila përcakton se Mercy Corps i jep AFK-së të gjitha të drejtat dhe interesat e saj lidhur me këtë hua.

Organizata operon me 31 zyra (2024: 29) në tërë Kosovën dhe zyra qendrore e saj ndodhet në Pejë, rruga "Lidhja e Prizrenit", Nr.1. Më 31 dhjetor 2025, Organizata kishte 272 punëtorë (2024: 270 punëtorë).

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1. Bazat e kontabilitetit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

2.2. Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro (ose "EUR"), e cila është monedha funksionale e Organizatës.

2.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të bëjnë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aseteve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive. Më specifikisht, informacionet mbi elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykime kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 5 dhe 6.

2.5 Parimi vijimësisë

Menaxhmenti i Organizatës ka bërë një vlerësim mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar me parimin e vijueshmësisë dhe mendon që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, menaxhmenti nuk është i informuar për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedh dyshime serioze mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar parimin e vijimësisë. Si rrjedhojë, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në këto pasqyra financiare nga Organizata.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi ose humbja në monedhë të huaj për transaksionet monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fundin e periudhës. Asetet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedhë të huaj, të cilat janë të matura me kosto historike, konvertohen me kursin e këmbimit valutor në datën e transaksionit.

3.2. Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje me anë të metodës së normës efektive të interesit.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo lëshimin e një aseti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje ose fitim përfshijnë interesin nga asetet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

Organizata llogarit të ardhurat nga interesi për asetet financiare, përveç atyre të konsideruara si kredi të zhvlerësuar duke aplikuar normën EIR në vlerën kontabël bruto të asetit financiar.

Kur një pasuri financiare bëhet e dëmtuar nga kredia dhe për këtë arsye konsiderohet në fazën 3, organizata llogarit të ardhurat e interesit duke aplikuar EIR në koston e amortizuar neto të aseteve financiare. Nëse pasuria financiare shëron dhe nuk është më e dëmtuar nga krediti, Organizata i rikthehet të ardhurave llogaritëse të interesit në bazë bruto.

3.3. Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aseti ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Kur një angazhim i huasë nuk pritët të rezultojë në tërheqjen e një kredie, tarifën e lidhura me angazhimin e kredisë njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Të ardhurat e tjera të tarifës dhe komisionit njihen në një shumë që pasqyron konsideratën për të cilën Organizata pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve. Detyrimet e performancës, koha sipas kënaqësisë së tyre, në një moment në kohë të caktuar ose në kohë identifikohen dhe përcaktohen në fillimin e kontratës.

3.4. SNRF 16 Qiratë

Organizata njeh asetet me të drejtën e përdorimit në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., datën kur aseti bazë është i disponueshëm për përdorim). Asetet e së drejtës së përdorimit maten me kosto, minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rimatje të detyrimeve të qirasë. Kostoja e aseteve të të drejtës së përdorimit përfshijnë shumën e detyrimeve të qirasë të njohura, kostot fillestare direkte të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në datën e fillimit ose para datës së fillimit. Asetet me të drejtën e përdorimit amortizohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Asetet e së drejtës së përdorimit janë paraqitur në shënimin 11.

Norma e matur mesatare mujore e huamarrjes e publikuar nga Banka Qendrore zbatohet nga Organizata për matjen e detyrimeve të qirave të reja ose të modifikuara, gjatë vitit 2025, këto

Agjencioni për Financim në Kosovë
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

norma ishin 6.6%. Organizata posedon me qira 31 zyre në Kosovë. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse nga 1 vit deri në 5 vite, por mund të kenë mundësi zgjatjeje.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.5. Tatimi mbi fitimin

AFK u krijua si organizatë jofitimprurëse dhe mori statusin e përfituesit publik në 2006. Bazuar në Ligjin mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave nr. 06 / L-105, Organizata nuk i nënshtrohet tatimit mbi fitimin.

3.6. Asetet dhe detyrimet financiare

a) Njohja

Organizata fillimisht njeh kreditë dhe huatë për klientët në datën kur ato janë ndermarrur. Të gjitha asetet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet dhe shitjet e rregullta) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Organizata bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aset ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

b) Klasifikimi dhe matja fillestare e aseteve financiare

Të gjitha asetet financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Asetet financiare, klasifikohen sipas kategorisë së mëposhtme:

- Kostoja e amortizuar (AC)
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet sipas:

- modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e asetit financiar
- Karakteristikave të rrjedhës së parasë kontraktuale të asetit financiar.

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)

Kushtet për aset financiar që do të klasifikohen në kategorinë "kosto e amortizuar" ose "vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse" ("FVOCI") është që kushtet kontraktuale të asetit financiar të japin rritje datat e flukseve të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar. Organizata ka kryer testin e SPPI dhe ka përcaktuar modelet e biznesit për asetet e saj financiare.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Organizata ka vlerësuar modelin e biznesit për pasuritë e saj financiare si më poshtë:

Huatë dhe paradhëniet për klientët

Kreditë dhe paradhëniet për klientët përbëhen nga aktivitete në fusha të ndryshme financimi si: bujqësia, shërbimet, konsumatori, tregtia, strehimi dhe prodhimi. Këto produkte janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale të principalit dhe interesit.

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve për klientët nuk është një aspekt thelbësor në administrimin e portofolit të Organizatës.

Modeli i biznesit i Organizatës sipas SNRF 9 është "HTC" dhe huatë dhe paradhëniet për klientët maten me koston e amortizuar.

Të gjitha aset financiarë klasifikohen aktualisht në kategorinë e kostos së amortizuar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6. Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Matja pasuese e aseteve financiare

Asetet financiare me kosto të amortizuar

Pas njohjes fillestare, këto asete maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Paraja dhe ekuivalentët të saj, kreditë dhe shumica e arkëtimeve të tjera, hyjnë në këtë kategori instrumentesh financiare.

Organizata ç'regjistron një aset financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhat e parasë së asaj pasurie nuk janë më të vlefshme, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e parasë të pasurisë nëpërmjet një transaksioni, i cili transferon në mënyrë thelbësore të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia mbi asetin financiar. Çdo interes mbi asetet e transferuara, i krijuar apo i mbajtur nga Organizata njihet si aset apo detyrim i veçantë.

Organizata ç'regjistron detyrimet financiare nëse detyrimet e detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

c) Kompenzimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Organizata ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Organizatës.

d) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aset ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principal ose, në mungesë të tij, tregu më i favorshëm në të cilin Organizata ka hyrje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e tij të mos performancës.

Kur është në dispozicion, përcaktimi i vlerave të drejta të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në kuotat e çmimeve të tregtarëve për instrumentet financiare të tregtuara në tregjet aktive. Një treg vlerësohet aktiv, nëse çmimet e cituara janë në dispozicion të rregullt dhe rregullisht përfaqësojnë transaksione reale dhe të ndodhura rregullisht në bazë të gjatësisë së krahut.

Nëse një treg për një instrument financiar nuk është aktiv, Organizata vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikat e vlerës aktuale të vlerës, metodën e zbritur të fluksit të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhguara të tregut, dhe modelet e vlerësimit. Për këto instrumente financiare, inputet në modele janë të vëzhguara nga tregu.

e) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë sipas SNRF 9 përdor informacionin dhe qasjet që organizata përdor për të menaxhuar rrezikun e kredisë. Organizata i segmenton produktet e saj të huadhënies me pakicë në portofole më të vogla homogjene, bazuar në karakteristikat kryesore që janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme. Të dhënat e aplikuara bazohen në të dhënat e grumbulluara historikisht të humbjeve dhe përfshijnë një grup më të gjerë karakteristikash si lloji i produktit si dhe karakteristikat e huamarrësit

Humbjet e kredisë llogariten duke përdorur një model zhvlerësimi tre faza, bazuar në faktin nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë së asetit financiar që nga njohja fillestare e tij.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6. Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

f) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Organizata aplikon një model për portfolet e saj kryesore në të cilat klientët e saj vlerësohen nga 1 në 4 duke përdorur notat e brendshme. Modelet përfshijnë informacione cilësore dhe sasiore dhe, përveç informacionit specifik për huamarrësin, përdorin informacione shtesë të jashtme që mund të ndikojnë në sjelljen e huamarrësit. Organizata aty ku është praktike përdor edhe informacionin nga Regjistri i Kredive në Kosovë. Ky burim informacioni përdoret fillimisht për të përcaktuar notat e vlerësimit brenda kornizës së Klasifikimit të Kredive të BQK-së. Klasat e brendshme të kredisë caktohen në bazë të këtyre shkallëve të kornizës së klasifikimit të kredive të BQK-së. PD-të më pas rregullohen për llogaritjet e SNRF 9 ECL për të përfshirë informacionin e ardhshëm dhe klasifikimin e ekspozimit në fazën e SNRF 9.

Inputet kryesore për matjen e humbjeve të pritura të kredisë janë termi i strukturës së variablave të mëposhtëm:

- Gjasat për mospagesë (PD)
- Humbjet për shkak të mospagesës (LGD), and
- (Humbja) e ekspozuar në rast të mospagesës (EAD).

Gjasat për mospagesë ("PD") – paraqet një vlerësim të gjasave për mospagesë brenda një spektri të caktuar kohor (ose 12 muaj ose gjatë tërë jetës). PD-ja vlerësohet duke përdorur të dhëna të paracaktuara të mbledhura 60 muaj, të rregulluara për informacionin e ardhshëm (PBB, GDP, shkalla e papunësisë dhe inflacioni). PD-të janë të përcaktuara për të gjitha nën-portfolet e lidhura me rrezikun (agro, biznes dhe familjar) dhe varen nga disa karakteristika të klientit (si klasifikimi i rrezikut për klientët e biznesit).

Pasiguria e natyrshme në perspektivën makroekonomike të periudhës së ardhshme trajtohet duke marrë në konsideratë disa skenarë makroekonomikë, duke i përdorur ato për të nxjerrë parashikimet alternative të PD-së së PiT-së dhe duke aplikuar një mesatare të ponderuar të tyre si parametrin përfundimtar për llogaritjen e ECL. Skenarët bazë, optimist dhe pesimist peshohen përkatësisht me 50%, 20% dhe 30% respektivisht.

PD 12 mujore llogaritet me përqindjen e kredive që kanë ngecur gjatë jetës së tyre. Përqindja bazohet në numrin e kredive dhe nuk ponderohet me shumën e mbetur. Nëse PD 12 mujore ose PD e shkallëzuar është më pak se 0,05% do të aplikohet një dysheme PD prej 0,05%. Dyshemeja PD është në përputhje me praktikat më të mira dhe amendamentin e Rregullores së BE-së për Kërkesat Kapitale (RRR3).

Humbja për shkak të mospagesës ("LGD") – paraqet një vlerësim të humbjes e cila paraqitet me rast të pagesës. Ajo bazohet në dallimin mes rrjedhës së kontraktuar të parasë së gatshme dhe asaj që huadhënësi pret të pranojë, duke përfshirë edhe ato nga çfarëdo kolaterali. Zakonisht shprehet si përqindje e EAD-së (Humbjes së Ekspozuar me rastin e mospagesës) Organizata për SNRF 9 LGD përdor LGD prej 75% për kreditë e fazës 1 dhe 2 dhe 100% për kreditë e fazës 3. Inputet për këto norma të LGD janë kalibruar përmes testimit mbrapa kundrejt rikuperimeve të fundit.

Një pasuri konsiderohet se ka dështuar nëse ndonjë ripagim (kryegjë apo interes) vonohet për më shumë se 90 ditë ose nëse pala tjetër është në një situatë të provuar dështimi (falimentimi). Organizata ka përafruar përkufizimin e saj të aktiveve të zhvlerësuar të kredisë sipas SNRF 9 me përkufizimin e BQK-së për kreditë me probleme (NPL-të).

Ekspozimi ndaj mospagesës ("EAD") - ky është një vlerësim i ekspozimit të mospagesës në një datë të paracaktuar, duke marrë parasysh ndryshimet e pritura në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë ripagimet e principalit dhe të interesit, dhe zbritjet e pritura në lehtësitë e angazhuara. EAD-i i një aktivi financiar përfaqëson vlerën kontabël bruto të tij në kohën e mospagimit, që i nënshtrohet llogaritjes së zhvlerësimit, duke trajtuar si aftësinë e palës tjetër për të rritur ekspozimin e saj ndërkohë që i afrohet mospagimit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.6. Aset dhe detyrimet financiare (vazhdim)

f) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Sidoqoftë, faktorët që duhet të merren parasysh kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë është rritur në mënyrë të konsiderueshme për të gjitha kreditë, dhe kështu përcaktimi për vendosjen e kredive janë renditur më poshtë:

- Klasifikimi i rrezikut të kredisë
- Prezumim i kundërshtueshem se (më shumë se 30 ditë vonesë tregojnë një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë).
- Treguesit e përgjithshëm të ndryshimeve të rrezikut të kredisë siç përcaktohet nga standardi
- Kërkimi përpara i informacionit

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari të lejimit kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi për aset e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes lëshimit të zbritjes. Kur një ngjarje pasuese bën që vlera e humbjes së zhvlerësimit të ulet, ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet përmes fitimit ose humbjes.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të bartura me koston e amortizuar maten si diferenca midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të parave të vlerësuar të zbritura në normën fillestare të interesit efektiv të aktiveve.

Organizata i shlyen kreditë e caktuara për klientët kur ato janë përcaktuar të pambledhshme.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Organizatës përfshijnë huazime nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe detyrimet e tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë. Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç për derivatet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat barten më pas në vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse). Organizata nuk ka përcaktuar asnjë detyrim si FVTPL.

Të gjitha tarifat që lidhen me interesin dhe, nëse është e aplikueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje, përfshihen në shpenzimet e interesit dhe të hyrat nga interesi.

Huamarrjet dhe borxhi i varur

Huazimet dhe borxhet e varura janë pjesë e burimit kryesor të financimit të Organizatës.

Huamarrjet dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Organizata paguan tatimin e mbajtur në burim prej 10% të shumave bruto të interesit të paguara huadhënësve të saj në përputhje me termat dhe kushtet e dakorduara.

3.7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra e likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga organizata për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Pasqyra e pozicionit financiar
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.8. Prona dhe Pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zyrat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit. Programi kompjuterik i blerë që është pjesë përbërëse e funksionalitetit të aktivitetit përkatës është kapitalizuar si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të ndryshme të një pajisjeje kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (përbërësit kryesorë) të pajisjeje.

Fitimet dhe humbjet gjatë largimit, janë përcaktuar duke krahasuar vlerën e marrë për aset me atë bartëse njihen në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Organizatë, dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare për të alokuar kostot e tyre për vlerat e tyre të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar:

	2025	2024
Pajisjet e zyrës dhe tjera	20%	20%
Kompjuterat dhe pajisje IT-së	20%	20%
Vetura	20%	20%

Përmirësimet në qira janë zhvlerësuar gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jeta e përdorimit rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe të raportimit.

3.9. Asetet e paprekshme

(i) Njohja dhe matja

Asetet e paprekshme të blera nga Organizata mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

(ii) Kostot vijuese

Shpenzimet e mëvonshme mbi asetet e paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aset specifik për të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në vijë të drejtë mbi jetën e vlerësuar të dobishme të pasurive. Jeta e dobishme e vlerësuar e pasurive të paprekshme është nga 3 deri në 5 vjet.

(iv) Dëmtimi i pasurive jo-financiare

Dëmtimi i pasurive jofinanciare i pronës impiantit dhe pajisjeve, i pasurive të paprekshme dhe i të drejtës së përdorimit të pasurive. Organizata vlerëson në çdo datë raportimi, nëse ka një tregues se një pasuri mund të dëmtohet. Nëse ekziston ndonjë tregues, menaxhmenti llogaritet sasinë e rikuperueshme të pasurisë. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e larta e një pasurie ose vlera e drejtë e CGU më pak kostot e asgjësimit dhe vlera e tij në përdorim. Shuma mbartëse reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja e dëmtimit njihet në fitim ose humbje për vitin.

Agjencioni për Financim në Kosovë
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.10. Përfitimet e punonjësve

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar kontributësh. Detyrimet për kontributet në planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Organizata ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyre të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

4. MIRATIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

Standardet e reja dhe ato të ndryshuara të lëshuara janë efektive për periudhën aktuale të raportimit.

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë – Ndryshimet në IAS 21 “Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit të monedhave të huaja”

Në gusht 2023, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) lëshoi një ndryshim në IAS 21 për të trajtuar situatat në të cilat një monedhë nuk mund të shkëmbehet lirshëm me një monedhë tjetër (zakonisht për shkak të kufizimeve të vendosura nga qeveria). Ndryshimi:

- Përcakton kur një monedhë konsiderohet e shkëmbyeshme dhe kërkon që subjekti të vlerësojë një kurs këmbimi “spot” nëse nuk është i disponueshëm.
- Prezanton kërkesa të reja për zbulim në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet e përdorimit të një kursi të vlerësuar.

Ky ndryshim është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2025 ose pas kësaj, me aplikim të hershëm të lejuar. Aktivitetet e Organizates nuk i nënshtrohen kontroleve të kursit të këmbimit dhe ajo nuk operon në juridiksione me monedha jo të shkëmbyeshme; për rrjedhojë, ky ndryshim nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat e saj financiare.

Kompania nuk ka aplikuar prononcimet e mëposhtme të reja ose të ndryshuara të IFRS-ve që janë lëshuar, por nuk janë ende efektive për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025:

- Ndryshimet në IFRS 9 dhe IFRS 7 – Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare. Këto ndryshime, të cilat do të zbatohen nga 1 janar 2026, sqarojnë kur detyrimet tregtare të shlyera përmes sistemeve elektronike të pagesave çregjistrohen; prezantojnë një test të ri SPPI për aktivet financiare me karakteristika të kontingjencës; dhe kërkojnë zbulesa të zgjeruara për instrumente të caktuara të kapitalit. Organizata po vlerëson ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.
- Ndryshimet në IFRS 9 dhe IFRS 7 – Kontratat që referojnë energjinë elektrike të varur nga natyra. Efektive nga 1 janar 2026, këto ndryshime sqarojnë përjashtimin “për përdorim vetjak” dhe kërkesat e kontabilizimit të sigurimit për kontratat për energjinë elektrike nga burime të rinovueshme të varura nga natyra dhe prezantojnë zbulesa të lidhura. Organizata po vlerëson ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.
- Përmirësimet vjetore të Standardeve të Kontabilitetit IFRS – Vëllimi 11. Këto përmirësime të vogla, të cilat hyjnë në fuqi më 1 janar 2026, adresojnë çështje në disa standarde, përfshirë IFRS 9, IFRS 1, IFRS 7, IFRS 10 dhe IAS 7. Kompania nuk pret që këto ndryshime të kenë ndikim të rëndësishëm.
- IFRS 18 – Paraqitja dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare. Ky standard zëvendëson IAS 1 dhe është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2027. Ai prezanton një deklaratë të strukturuar të fitimit ose humbjes, nëntotale të reja dhe “masa të performancës së menaxhimit”, si dhe udhëzime të përmirësuara për shpërbërjen dhe paraqitjen. Organizata po vlerëson ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve.
- IFRS 19 – Filialet pa Llogaridhënie Publike: Zbulime. Efektive nga 1 janar 2027, IFRS 19 u lejon filialeve të pranueshme të zbatojnë kërkesat e njohjes dhe matjes së IFRS-ve duke ofruar zbulesa të reduktuara. Organizata do të vlerësojë pranueshmërinë dhe adoptimin.
- Ndryshimet në IFRS 10 dhe IAS 28 – Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një investitori dhe shoqërisë së tij të lidhur ose sipërmarrjes së përbashkët. IASB ka shtyrë pafundësisht datën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve. Organizata do të monitorojë zhvillimet. Organizata nuk synon të adoptojë në mënyrë të parakohshme prononcimet e mësipërme.

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR.

5.1. Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm

Organizata është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiare të saj:

- Risku kreditor
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Ky shënim shpalos informacionin mbi ekspozimin e Organizatës ndaj secilit prej risqeve më lart, objektivat e Organizatës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të Organizatës.

Korniza e menaxhimit të riskut

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë finale për të vendosur dhe mbikëqyrur kuadrin e menaxhimit financiar të Organizatës. Bordi dhe menaxhmenti kanë ngritur komitete të ndryshme të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të riskut në tërësi.

Politikat e organizimit të menaxhimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Organizata, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Organizata, nëpërmjet trajnimit dhe procedurave dhe politikave të saj për menaxhim, synon të zhvillojë një mjedis konstruktiv kontrolli, në të cilin të gjithë punëtorët i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

5.2. Risku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku që nëse një klient apo një palë në një instrument financiar dështon që të përmbush detyrimet e tija financiare dhe kjo shkakton që Organizata të pësojë një humbje. Organizata menaxhon riskun kreditor duke u marrë vetëm me palët e aprovuara sipas kushteve specifike të kredisë. Ekspozimi kryesor i Organizatës ndaj rrezikut të kredisë lind nëpërmjet huave të klientëve.

Përqendrimet e riskut të kredisë (qoftë në bilanc ose jashtë bilancit) lindin nga pamundësia e klientëve për të përmbushur detyrimet kontraktuale të cilat mund të preken nga mjedisi operativ ose ciklet e tyre të biznesit. Organizata nuk ka ekspozim të konsiderueshëm ndaj asnjë klienti dhe zakonisht nuk jep kredi më shumë se 25,000 euro për një klient të vetëm.

Organizata gjithashtu ka ekspozim ndaj bankave në formën e llogarive bankare dhe depozitave. Risku kreditor në lidhje me bankat menaxhohet nëpërmjet alokimit të fondeve në dispozicion në banka të ndryshme që veprojnë në Kosovë.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar. *Menaxhimi i riskut kreditor*

